- Zyra e Debrecenit: 4024 Debrecen, Szent Anna u. 31., tel: +36-52-349-657. Drejtori i rajonit: Pósa Kálmán.
- Zyra e Szegedit: 6721 Szeged, Tisza Lajos krt. 25., tel: +36-62-425-505. Drejtori i rajonit: Radóczy Tibor
- Zyra e Szekesfehervarit: 8000 Szekesfehervár, Sóstói út 3., tel: +36-22-333-167. Drejtori i rajonit: Földi Attila

Produktet e Forever Living Products dalin në treg me rekomandimin e Shoqatës së Mjekësisë Popullore të Hungarisë.

I lutemi Distributorëve të nderuar, që bashkë me formularin e tyre të regjistrimit të dorëzojnë edhe kopjen e lishencës së tyre, si dhe kopjen e dokumentit të paraqitjes së Zyrës së Taksave dhe Tatimeve të ndërmarrjeve. Ata partnerë të Hungarisë, të cilët për blerjet e bëra dëshirojnë të nxjerrin llogari në emrin e ndërmarrjes së tyre personale, mund ta bëjnë këtë vetëm në rast se dërgojnë dokumentet e duhura të plotësuar, dhe një kopje të dokumentit që vërteton pozitën e tij si pronar i ndërmarrjes. Njoftimi, që ka të bëjë me këtë, është i nxjerrë në zyrat tona, por kolegët tanë mund t'ju njoftojnë edhe me fjalë në këtë aspekt.

Njoftim rreth mundësisë së blerjes me ulje
Për të përdorur mundësinë e blerjes me ulje ju lutemi zbatoni rregullat e mëposhtme:

- 1. Deklarata:** Ju lutemi që me vëmendje plotësoni saktësisht çdo pjesë të deklaratës. Nëse e dërgoni personalisht kolegët tanë i kontrollojnë të dhënat, por nëse e dërgoni me postë kjo gjë nuk është e mundur, prandaj ju lutemi që me një vëmendje të madhe kontrolloni të dhënat tuaja, sepse në rast gabimi sistemi i uljes së çmimeve nuk hyn në fuqi.
- 2. Blerja:** Gjatë blerjes sistemi i ofron shumë maksimume të uljes atyre që e plotësojnë deklaratën. Blerja do të thotë përdorimin e uljes së çmimeve ose pagesën e bonusave, kështu edhe blerja personale kërkon letërnjoftim me fotografi. Në rastin e blerjes si grup duhet të sillni autorizim të nënshkruar nga dy dëshmitarë të rregullt nga çdo person, për çdo porosi. Kolegët tanë i pranojnë porositë vetëm pasi i kanë kontrolluar

këto gjëra. Në rastin e personave me deklaratë mungesa e letërnjoftimit apo e autorizimit sjell refuzimin e porosisë!

3. Informimi: Kolegët tanë nëpër magazina vetëm pas paraqitjes së letërnjoftimit me fotografi dhe dorëzimit të autorizimeve japin informacione rreth shumës aktuale të uljes.

Bashkëpunonjësit me deklaratë dhe që i marrin bonusat e tyre në formë kuponash, mund të informohen rreth shumave të sakta në adresën Budapest, Szondi u. 34.

Dëshiroj t'u thërras vëmendjen distributorëve të Hungarisë për shërbimin tonë të transportimit të pakove. Me anë të këtij shërbimi Distributort tanë të Nderuar i marrin porositë e bëra maksimum brenda 2 ditëve – me përputhje kohe – në çdo pikë të vendit, të cilat duhen marrë brenda 48 orëve, pasi në rast të kundërt ato i anulohet dhe pikët i zbrisim. Çmimi i produkteve të porositura dhe ai i transportit duhet paguar kur pakoja merret në dorë. Në rastin e blerjes me vlerë mbi 1 pikë shpenzimet e transportit paguhen nga kompania.

Porositë tuaja mund t'i bëni në mënyrën e mëposhtme:
– në telefon, ku punonjësi ynë ju jep informacione të sakta rreth shumës së porosisë, vlerës së saj në pikë dhe çmimit të transportit. Numrat e telefonit: 061-297-5538, 061-297-5539, cel: 0620/456-8141, 0620/456-8149
– nëpërmjet internetit në adresën www.flpshop.hu,
– me sms në numrin e telefonit 0620-478-4732.

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Hungarisë:

Dr. Gabriella Kassai: +36-30-307-7426
Dr. György Bakanek: +36-20-944-1442
Nëpërmjet kontaktit telefonik i pret për konsultim personal të gjithë punonjësit. Vendi i konsultimit është wqendra e rrugës Sondi.
Dr. Laszlo Kerekes: +36-20-944-1442
Dr. László Mezösi, veteriner: +36-20-552-6792

Njoftimet e Szirakit:

Hoteli Késhtjella e Szirakit, 3044 Szirák, Petöfi u. 26.
Tel: +36-32-485-300, fax: +36-32-485-285
Drejtorja e hotelit: Király Katalin



NJOFTIMET E ZYRAVE TË SERBISË

- Zyra e Beogradit: 11000 Beograd, Kumodraska 162, tel.: +381-11-3970-127. Orari i hapjes: të hënën, të martën dhe të enjten 12.00-19.30, të mërkurën dhe të premten 9.00-16.30.
- Zyra e Nisit: 18000 Niš, Učitelj Tasina 13/1., tel.: +381-18-514-130, +381-18-514-131. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 11.00-19.00, në ditët e tjera të punës 9.00-17.00.
- Zyra e Horgosit: 24410 Horgoš, Bartok Béla 80. tel.: +381-24-792-195. Orari i hapjes në ditët e punës: 8.00 - 16.00. Drejtori i rajonit: Branislav Rajic.

– Forever Living Products Beograd na ofron shërbimet e mëposhtme: bërje porosish në telefon - Telecenter. Numri i telefonit: 011/309-6382. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12: 00-19.30, në ditët e tjera të punës 9:00-16.30. Në rastin e porositjes në telefon malli shkon tek adresa që gjendet në numrin e kodit dhe paguhet kur merret në dorë.

- Shpenzimet e postës paguhen sipas kursit të PTT Serbisë të ditës që ndodh shërbimi, por FLP-ja e Beogradit i paguan vetëm nëse porosia e bërë në një numër kodit e kalon 1 pikë krediti.
- Nuk mund të bëhet hyrje nëpërmjet telefonit.
- Porositë telefonike merren në shqyrtim deri në datën 25 të muajit, pas kësaj date mund të porosini vetëm personalisht në zyrën tonë.
- Edhe në zyrën e Horgosit dhe Nisit mund të blihen materiale reklamash dhe gjithë llojet e formularëve. Distributorët tanë mund të blejnë edhe fletat e regjistrimit dhe formularët për ndryshimin e të dhënave.

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Serbisë:

Dr. Biserka Lazarević dhe Dr. Predrag Lazarević: +381-23-543-318. Ata i presin thirrjet tuaja për konsultim të martën në orën 13.00-16.00 dhe të premten në orën 14.00-16.00. Dr. Božidar Kaurinović të mërkurën dhe të enjten në orën 12-14 pret thirrjet tuaja për konsultime në numrin e telefonit +381-21-636-9575.



NJOFTIMET E ZYRËS SË MALIT TË ZI

- 81000 Podgorica, Serdara Jola Piletića br. 20. tel: +381-081-245-402, tel/fax: +381-081-245-412. Drejtori i rajonit: Aleksandar Dakic

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Malit të Zi:

Dr. Laban Nevenka: +381-69-327-127



NJOFTIMET E ZYRAVE TË BOSNIA-HERCEGOVINËS



Zyra e Bijelinës

- Zyra e Bijelinës: 76300 Bijeljina, Trg Đenerala Draže Mihajlovića br. 3., tel: +387-55-211-784, +387-55-212-605, fax: +387-55-221-780. Orari i hapjes në ditët e punës: 9.00-17.00.

- Zyra e Banja Lukas: 78 000 Banja Luka, Duško Koščica u. 22., tel.: +387-51-228-280., fax: +387-51-228-288. Drejtori i rajonit: Dr. Slavko Paleksic. Orari i hapjes: në ditët e punës 9.00-16.30
- Zyra e Sarajevës: 71000 Sarajevo, Akifa Seremeta do. 10., tel.: +387-33-760-650, +387-33-470-682, fax: +387-33-760-651.. Orari i hapjes: të hënën, të enjten, të premten: 09.00-16.30, të martën, të mërkurën: 12.00-20.00. Në çdo të shtunë të fundit të muajit organizojmë një Ditë Suksesi Mini në zyrën e FLP-s. Drejtori i zyrës: Enra Hadžović Në zyrat e Forever Living Products të Bosnias porositë telefonike mund të bëhen në numrat e mëposhtëm (regjistrimi i shpërndarësve të rinj nuk mund të bëhet nëpërmjet telefonit): +387-55-211-784, Bijelinë dhe +387-33-760-650 Szarajevë.

Njoftim i zyrës së FLP-s së Sarajevës

– Nga shtatori në shërbimin tonë është këshilltarja dhe specialistja mjekje nga Bosnia-Hercegovina Dr. Esmā Nisic, me të cilën mund të kontaktohem në numrin e telefonit: +387-62-367-545 gjatë ditëve të punës në orarin: 18:00 – 21:00.

– Këshilltarja dhe specialistja jonë mjekje çdo të mërkurë mban konsultime në zyrën e Sarajevës në orën 17:00 – 19:30.

– Në rastin e porosisë telefonike pagesa bëhet kur merret malli. Nëse vlera e porosisë është më e madhe se 1 pikë krediti, atëherë shpenzimet e transportit paguhen nga distributori.



NJOFTIMET E ZYRAVE TË KROACISË

- Zyra e Zagrebit: 10000 Zagreb, Trakošćanska 16., tel.: +385-1-390-9770., fax: +385-1-3909-771. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00; të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00.
- Zyra e Splitit: 21000 Split. Križine 19. tel.: +385-21-459-262. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00; të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00. Drejtori i rajonit: Dr. Molnár László

– Porosia telefonike bëhet në numrin +385-1-3909-773. Nëse vlera e porosisë është më e madhe se 1 pikë, shpenzimet e transportit i paguan FLP-ja.

– Leksionet rreth marketingut dhe produkteve fillojnë çdo të hënë dhe të enjte në orën 18.00 në zyrën qendrore.

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Kroacisë:

Dr. Ljuba Rauski Naglic: +385-915176510

Dr. Eugenija Sojat Marencic: +385-915107070



NJOFTIMET E ZYRAVE TË SLOVENISË

- 1236 Trzin-Ljubljana, Borovec 5., tel: +386-1-562-3640. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00, të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00.
- Adresa e magazinës së Lendvait: Kolodvorska 14., 9220 Lendava. tel.: +386-2-575-12-70, Fax: +386-2-575-12-71, e-mail: forever.living@siol.net. Orari i hapjes: të hënën 12.00-20.00, të martën dhe të premten 09.00-17.00. Drejtori i rajonit: Kepe Andrej

Numri i Telecenterit (ku bëhen porositë telefonike) është: 01/563-7501

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Sllovenisë:

Dr. Arbaiter Miran: +386-41420788

Dr. Canzek Olga: +386-41824163



Zyra e Lendvait



NJOFTIMET E ZYRËS SË SHQIPËRISË

- Shqipëri, Tiranë, Reshit Collaku 96, Villa Forever 36. Fax: +355 4230 535

Drejtori i rajonit: Geza Gergó Kalovics, tel: +36-20-5755-553

www.flpseeu.com **FLP TV** në internet

Programi i FLP TV nga 19 janar 2008 deri më 22 shkurt 2008

18.00 dhe 06.00 Konkursi i zërit i festës
18.25 dhe 06.25 Përmbledhje
18.28 dhe 06.28 Europa Rally & Profit Sharing 2008 Budapest
18.30 dhe 06.30 Edhe Ti mund të shkëlqesh si Diamant
19.25 dhe 07.25 Pomesteen
19.30 dhe 07.30 Një vit i bukur si anëtar i President's Club
20.00 dhe 08.00 Koncert feste
20.25 dhe 08.25 Shampoo
20.30 dhe 08.30 Dhjetë vjet-një datë, një histori e cila mund të bëjë fjalë edhe për ty
21.00 dhe 09.00 Riporter: Zsuzsa Lenkey
21.25 dhe 09.25 Koncert
21.45 dhe 09.45 Suksesi i punës në skuadër
22.10 dhe 10.10 Nature 18
22.15 dhe 10.15 Fëmijë të shëndetshëm
22.35 dhe 10.35 Aloe 2 go

22.37 dhe 10.37 Europa Rally & Profit Sharing 2008 Budapest
22.40 dhe 10.40 Qëllime, vizione, pamje e të ardhmes
23.20 dhe 11.20 Programi gazmor i festës
23.30 dhe 11.30 Riporter: Kata Fekete
00.05 dhe 12-05 Përmbledhje
01.00 dhe 13.00 Koncert
01.30 dhe 13.30 Europa Rally & Profit Sharing 2008 Budapest
01.35 dhe 13.35 Mposhtja e armikut të vjetër të rjetndërtuesve
01.45 dhe 13.45 Nga bima deri tek produkti
01.55 dhe 13.55 Plani marketing i FLP-s
02.15 dhe 14.15 Metoda ABC
03.05 dhe 15.05 Koncert
03.30 dhe 15.30 Teknika e të pyeturit
04.45 dhe 16.45 Bindje
05.10 dhe 17.10 Koncert
05.35 dhe 17.35 Europa Rally & Profit Sharing 2008 Budapest

PROGRAM

21 shkurt 2008, e enjte

Të kualifikuarit në nivelin e 2-të dhe të 3-të të Rally-t European dhe ata të Profit Sharing i zunë dhomat e hoteleve nga ora 15:00. Për ata që mbërrin më parë ekziston mundësia t'i lenë bagazhet në hotel. Banaku i informacionit të Rally-t në hotel hapet në orën 8 të mëngjesit. Ju lutemi që të enjten të merrni pakot tuaja të Rally-t, kartat e identifikimit, shiritin e dorës dhe vërtetimin tuaj.

22 shkurt 2008, e premte

Të kualifikuarit e nivelit I të Rally-t European mund t'i marrin pakot e tyre të Rally-t nga ora 10 deri në orën 14 në Arenën Sportive.

Banaku i informacionit të Rally-t është hapur nga ora 8 deri në orën 12.

Në orën **12:00** nisen autobuzat që transportojnë të kualifikuarit e Profit Sharing dhe nivelit të 2-të dhe të 3-të të Rally-t European. Rruga zgjat afërsisht 20 minuta.

Në orën **14:00** fillon Rally European & Profit Sharing në Arenën Sportive të Budapestit dhe zgjat deri në orën **20:00**.

Në ditën e parë të Rally-t rekomandohet veshje e përditshme elegante ose kostum popullor. Ndalohet përdorimi i borive dhe trombave në Rally.

Në konkursin për skuadrën më entuziaste – **Spirit Award** – në vitin 2008 çmimi do të jepet në bazë të këngëve/rimave dhe entuziazmit – cila skuadër i bën më shumë tifozllëk distributorëve të vet. Kurse çmimi **Country Pride Award 2008** përqendrohet në individualitetin dhe unitetin e vendeve.

Në fund të Rally-t të kualifikuarit e Profit Sharing dhe nivelit të 2-të dhe të 3-të të Rally-t European transportohen me autobuza nga Arena nëpër hotele. Rruga zgjat afërsisht 20 minuta. Autobuzi i fundit niset një orë pas përfundimit të Rally-t. Në mbrëmje program i lirë.

23 shkurt 2008, e shtunë

Orari i hapjes së banakut të informacionit të Rally-t është në mëngjes nga ora 8 deri në 9:30.

Në **9:30** nisen autobuzat që transportojnë të kualifikuarit e Profit Sharing dhe nivelit të 2-të dhe të 3-të të Rally-t European. Rruga zgjat afërsisht 20 minuta.

Rally European & Profit Sharing në Arenën Sportive të Budapestit zgjat nga ora **11:00 deri në orën 17:00**. Informacionet e dhëna në ditën e parë janë të vlefshme edhe për ditën e dytë. Në fund të ditës ju lutemi të na ktheni aparatet e përkthimit që të mund të merrni prapa 50 Eurot e lëna si garanci.

Në fund të Rally-t të kualifikuarit e Profit Sharing dhe nivelit të 2-të dhe të 3-të të Rally-t European transportohen me autobuza nga Arena nëpër hotele. Rruga zgjat afërsisht 20 minuta. Autobuzi i fundit niset një orë pas përfundimit të Rally-t.

Të shtunën në mbrëmje mbajmë një **banket** për të kualifikuarit e Rally-t European dhe Profit Sharing në **Pallatin Syma** i cili gjendet pranë Arenës.

Të kualifikuarit e Profit Sharing dhe nivelit të 2-të dhe të 3-të të Rally-t European transportohen me autobuza nga hotelet në Pallatin Syma. Rruga zgjat 20 minuta. Rekomandohet veshje e përditshme elegante ose kostum popullor.

Darka shtrohet në orën 21:00 (ju lutemi ta keni parasysht që darka shërbehet – s'është me sistem bufeje – prandaj ata që vijnë me vonesë nuk do të shërbehen). Pas darkës të kualifikuarit argëtohen me muzikë, shfaqje të drejtpërdrejta dhe muzikë vallëzimi.

Banketi i të kualifikuarve zgjat deri në orën 2 të natës. Nga ora 22:30 autobuzat i transportojnë vazhdimisht të kualifikuarit nga Pallati Syma nëpër hotele. Rruga zgjat afërsisht 20 minuta. Autobuzi i fundit niset në orën 2 të natës.



24 shkurt 2008, e djelë

Nga hotelet duhet larguar deri në orën 12. Ai që mund të largohet nga Budapesti vetëm pas orës 12, mund t'i lejë çantat në dhomën e ruajtjes së çantave të hotelit.

NDARJA E HOTELEVE

- INTERCONTINENTAL BUDAPEST HOTEL
Shtetet Baltike, Shtetet Benelux, Çekia, Francia, Italia, Rumania, Skandinavia, Sllovakia, Turqia, Ukraina
- KEMPINSKI HOTEL CORVINUS BUDAPEST
Islanda, Irlanda, Izraeli, Polonia, Spanja, Mbretëria e Bashkuar
- SOFITEL BUDAPEST HOTEL
Bosnia, Greqia, Kazakistani, Hungaria, Rusia, Serbia, Turqia

– LE MERIDIEN BUDAPEST HOTEL

Bullgaria, Gjermania/Austria, Portugalia, Zvicra

Distributorët, miqtë dhe familjarët që nuk mund të marrin pjesë në Rally, i njoftojmë se Rally European & Profit Sharing mund të ndiqet drejtpërdrejt në FLP TV hungarez në internet. Adresa e faqes së internetit: www.fullarts.com/flp Kurse fotografitë e Rally-t mund të shihen nga 25 shkurti në faqen e internetit a www.flp-pics.com

MOTI

Meqë Rally organizohet në dimër, moti mund të jetë i ftohtë. Në Budapest temperatura mesatare e shkurtit është 8 deri në -2 °C. Është mirë të sillni roba të ngrohta!





Vetëm një senior...

Ka më shumë se katër vjet që i njoh produktet.
Kur produktet dhanë prova mendova ta shikoja
pak edhe biznesin.

Brenda një periudhe të shkurtër u bëra supervisor, pasi gjeta disa bashkëpunonjës. Pas gjysëm viti arrita nivelin e managerit dhe në jetën time filloi ndryshimi. Nuk besoja se edhe unë do të kem sukses, pasi kisha dështuar disa herë në jetën e biznesit, dhe mendova se unë me siguri s'kam aq fat sa të bëhem manager apo të arrij



nivele edhe më të larta. E di që shumë njerëz mendojnë në këtë mënyrë. "Përse të ketë sukses pikërisht ai?" Por tani e di se nuk varet nga fati, por vetëm nga unë. Sa seriozisht e merr biznesin dhe çfarë qëndrimi mban. Kërkon pretekste apo punon ashtu siç duhet, dhe atëherë të ndryshon jeta.

Mund të bësh shumë gabime në rrugën drejt suksesit, prandaj i rekomandoj të gjithëve që të mos bëj asgjë pa sponsorin e tij dhe ta dëgjoj atë për gjithçka. Tregohu këmbëngulës edhe nëse nuk arrin gjithçka me të parën, vetëm rezultati përfundimtar ka rëndësi dhe më besoni, nga niveli i managerit ju përfundojnë të gjitha problemet. Unë i falenderoj shumë sponsorët e mi, **Karoly Lerant**-in dhe bashkëshorten e tij **Edina**, që në periudhat e vështira ishin pranë meje, më dhanë dorën dhe më ndihmuan.

I falenderoj ata për punën e tyre këmbëngulëse dhe shembullin e dhënë. Jam shumë i gëzuar që mund të ndihmoja dy njerëz të mrekullueshëm që të bëhen manager, dhe i falenderoj që e pranuan nga unë këtë biznes dhe që dëshirojnë të jetojnë ndryshe nga njerëzit e tjerë. I respektoj dhe vlerësoj për këmbënguljen dhe qëndrimin e tyre managerët e mi të parë, **Marti Seregelyes** dhe bashkëshortin e saj **Gabor**, dhe managerin tim të dytë **Sandor Stahlmayer**. Falenderoj në mënyrë të veçantë linjat

e mia të sipërme, **Pisti Utasi**-n, **Zsolti Leveleki**-n dhe **Robi Varga**-n për kurset përgatitore kur u morrën në mënyrë të veçantë me mua dhe më mësuam të bëhem një drejtues mirë. Falenderoj **Rex Maughan**-in që e ëndërroi dhe e krijoi këtë kompani të mrekullueshme, duke u siguruar me këtë të gjithëve mundësi për të ndryshuar jetën. Mua FLP-ja gjatë viteve të kaluara më dha edhe shumë miq të mirë e të vërtetë, si **Csaba Juhasz** dhe **Agi Klaj**, apo **Zsuzsi Kapitany** dhe bashkëshorti i saj, si dhe **Eszter Farkas** dhe bashkëshorti i saj. Jam krenar që kam miq të tillë.

Nuk jam në gjendje të mendoj pa ndjenja për familjen time, e cila është shumë e rëndësishme për mua, për prindërit dhe vëllanë tim, pa të cilët nuk do arrija dot ta ndërtoja këtë biznes. Ata kanë qenë gjithmonë shembujt e mi të vërtetë, jam përpjekur gjithmonë t'u përgjigjem kërkesave të tyre, sepse është e vërtetë që patën besim tek unë, por gjithmonë më thonin të zgjedh një punë të mirë, me të cilën mund të jetoj dhe të kërkoj mjaft para. Tani e shohin se kam bërë një zgjedhje të mirë dhe ndodhem në vendin e duhur në FLP. Jam krenar për ta dhe i falenderoj që më qëndruan pranë dhe më edukuan.

Ps: "Fati ndihmon vetëm ata që përballohen pa frikë me sfidat. Shfrytëzoje mundësinë dhe bëje të tëndin momentin!!!"



E dini që unë kam lindur dy herë. Për herë të parë kur erdha në këtë botë. Për herë të dytë kur hyra në familjen e madhe të Forever-it.

Përdor shprehjen lindje sepse të dy rastet ia di për faleminderit nënës sime. Nënës sime, **Tasnadi Lajosne-s**, e cila është gjithashtu managere me të drejtë autori në FLP. Por lindja ime e dytë ishte më e vështirë se e para. Kjo ishte rezultat i një përpjekje tre mujore e cila ndodhi tre vjet më parë.

Mendoj se çdo sukses është një fitore personale, dhe këtë fitore mund ta arrijë kushdo, pasi nëse mposht vetveten atëherë ke fituar. Kjo është alfa dhe omega e këtij biznesi. Nëse mposht vetveten atëherë ke fituar.

Jemi fitues në Klubin e Sundimtarëve. Në këtë klub hyjnë ata që janë në gjendje të mposhtin vetveten, frikën dhe rrethanat e tyre.

Hymë me të vërtetë në këtë klub, sivjet dy herë. Në prill fituam, por kjo fitore ishte edhe suksesi i bashkëpunonjësve tanë. Pasi në prill dy bashkëpunonjësit tanë u kualifikuan njëkohësisht në nivelin e managerit, kështu ne u bëmë seniorë dhe u kualifikuam edhe në nivelin e parë të programit motivues të makinës. Në këtë mënyrë në të njëjtën ditë me ta morrëm vlerësimin nga Rex Maughan. Ajo ishte një Ditë Suksesi e

Kam lindur dy herë



mrekullueshme, një nga ditët vendimtare të jetës sonë.

Por për këtë sukses duhet të mposhtim vetveten, frikën dhe rrethanat tona. Sepse më besoni kemi patur, kemi dhe do të kemi.

3 vjet më parë si rezultat i ftesave këmbëngulëse për 3 muaj me radhë të nënës sime, shkova nga Debreceni në Miskloc në një prezantim të hapur, por vetëm sepse shpresoja se po të shkoja njëherë këtë mundësi nuk do më ngacmojë më dhe do më lejë të qetë.

Kush ka shkuar në një prezantim vetëm që ta lenë të qetë? Me sa e di unë ishim shumë të tillë, por ndodhemi akoma këtu.

Nuk e di, do ia vllente të ftoje për 3 muaj me radhë dikë, nëse disa muaj më vonë

e sheh të kualifikohet në skenë, natyrisht në biznesin tënd. E sigurt! Por pavarisisht nga kjo, janë të shumtë ata që dorëzohen shpejt.

Nëna ime nuk u dorëzua, sepse kishte besim në këtë mundësi dhe pikësynimet e saj ishin më të forta se frika. Dëshironte t'i jetonte vitet e pensionit në mënyrë të shëndetshme dhe me dinjitet, por për këtë pensioni prej 40000 Forintash që merrte pas 40 vjet pune nuk i siguronte fonde të mjaftueshme materiale.

Prandaj më ftoi, më ftoi dhe unë shkova.

Në këtë kohë unë dhe nëna ime kishim 4 vjet që i përdornim produktet. Por mundësinë e biznesit e refuzoja plotësisht. Sepse nuk kisha informacionet e duhura rreth tij, në të vërtetë nuk kisha asnjë informacion.

Kisha mendimet dhe përvojat e mia personale rreth tregëtisë. Bashkëshorti im është inxhinier dhe ekonomist, prandaj kishim prej 20 vitesh biznese serioze në tregun e makinerive dhe kapitaleve të patundshme. Në mungesë të informacioneve nuk e imagjinonim dot mundësinë madhështore të biznesit që fshihej pas kutive të xhelit.

Por fitoi nëna ime, dhe unë shkova, për fat të keq vetëm, pa bashkëshortin tim, madje

edhe në seminarin start që erdhi më pas.

Ky ishte rasti i parë që mposhta vetveten, madje më mposhti edhe mundësia e biznesit.

Atëherë mendoja vetëm se po të bashkohem me nënën time, do e ndihmoj të arrij 25 pikë, me të cilat do të ketë të ardhura të tilla që nuk do ketë më nevojë të shtrëngojë rripin për të jetuar në mënyrë të denjë.

Por edhe duhet të mposhtja rrethanat në shtëpi, bashkëshortin tim, pasi ai nuk erdhi me mua në asnjë aktivitet. Sipas tij kjo është diçka e kotë, mund të jetë gjithçka, por jo një mundësi fantastike biznesi.

Arrita ta qetësoj me faktin se po ndihmoja vetëm mamanë të arrijë 25 pikët, pastaj do të heq dorë, të cilën atëherë edhe unë kështu e mendoja. Nivelin 25 pikësh e arritëm shumë shpejt. Por gjatë kësaj bëra shumë bashkëpunonjës dhe miq, të cilët nuk mund t'i lija në baltë, pasi u kisha premtuar diçka. U kisha premtuar se do t'i drejtoj ata në një rrugë ku mund të realizojnë ëndrrat e tyre.

Atëherë edhe mua më drejtonin, më morrën përdore njerëz të shkëlqyer si Janos Tamas dhe Etus, me të cilët krenohem, pasi ata nga

muaji në muaj ndodhen në radhët e para në Klubin e Sundimtarëve.

Janë shembuj të vërtetë për të gjithë ne.

Janos-i me një durim të pafund më morri përdore dhe më udhëhoqi hap pas hapi. Mësova prej tij durimin dhe sakrificën, me mjeshtërinë e tij më mësoi profesionin. Sepse ky është një profesion. Pas nënës sime ai është njeriu i parë të cilit ia di për faleminderit që sot ndodhem këtu në këtë biznes.

Njëherë diku lexova se **nuk mund ta urdhërojmë suksesin, por mund të bëjmë diçka akoma më të madhe: t'i shërbejmë atij.**

Puno në mënyrë të tillë që t'i shërbes suksesit.

Dhe për këtë nevojitet që kur të planifikojmë t'i shtrojmë vetes pyetjen:

A u shërben të tjerëve ajo që duam të bëjmë?

Janos-i këtë më mësoi dhe ua mëson të gjithëve. Prandaj është aq i suksesshëm. Këtë mësova edhe nga **Ilo-na Nogradi**, sponsorja e nënës sime, të cilën unë e quaj ëngjëll e Forever-it, pasi nëse kam nevojë ajo shfaqet kudo dhe kurdo, bën detyrën e saj, ndihmon kur nevojitet. Morrëm ndihmë të madhe prej saj gjatë kualifikimeve tona, për të cilën e falenderojmë shumë.

Arrita 25 pikët. Tani isha e bindur se do të shkoj mëtej në këtë rrugë. Burri im tani më shoqëroi për herë të parë në Ditën e Suksesit. Për të kjo ishte Dita e Suksesit E PARË, por jo e fundit. Si specialist ekonomie dhe tregëtar që ishte e dalloj mundësinë e biznesit. Sepse në bizneset tona pikëpamja kryesore ishte të qëndronim në këmbë në sa më shumë pika. Tha se meqë s'ke për të hequr dorë, atëherë ta bëjmë deri në fund dhe në mënyrë profesioniste, pasi kjo përmban më shumë se plotësimin e pensionit të

nënës. Sot veprimtarinë tonë në FLP e konsiderojmë një nga bizneset tona më serioze.

Dhe kur gjithçka fillon të ecë bukur, arritëm të mposhtim veteveten, atëherë erdhën përsëri rrethanat. Nënës e burrit tim u sëmur dhe pasoi një mjekim prej 6 muajsh. Nuk bëhej fjalë për ndërtime aktive biznesi dhe zhvillim, edhe qarkullimin mezi e mbanim. Shumë njerëz do të thonin që kaq ishte.

Kurse Unë thashë: në rregull, tani të mësojmë. Lexova shumë libra në lidhje me MLM-n dhe dëgjova kaseta të shumta. Thonë që ky biznes mund të ndërtohet brenda **x plus 6 muaj**.

Për mua kjo ishte periudha x, pastaj pas 6 muajve u bëmë me të vërtetë Manager. Gjatë periudhës së mësimit për fat të keq bashkëpunonjësit e mi u dorzuan.

Mund të humbasësh paratë në bankë, mund të të falimentoj biznesi, por nëse humbet angazhimin, atëherë ke humbur gjithçka, madje humbja e gjëra të mira të shtyn të gërmosh akoma më thellë për të gjetur gjëra më me vlerë.

Unë gjeta një me vlerë të jashtëzakonshme. – U takova me **Ildiko Nagy Juhasz-ne dhe Laci Juhasz-in**, me të cilët brenda disa ditësh filluam të punonim. Ata janë bashkëpunonjës të jashtëzakonshëm, shembujt e vullnetit dhe këmbënguljes, ata janë një nga gurët e çmuar, managerët, e biznesit tonë senior. Tek ata mund të mbështetesh kurdo dhe kudo. Skuadra e tyre e madhe dhe e zellshme i ndjek ata me përkushtim, nga kjo skuadër po rriten drejtues të jashtëzakonshëm.

Assistant Managerët **Judit Ferenczi dhe Lorant Illyes**, të cilët e ndërtojnë skuadrën e tyre me një besim dhe entuziazëm të madh. Duke

përmendur fjalët e Napoleon Hill-it, ata janë njerëzit të cilëve bota u siguron hapsirë, pasi fjalët dhe veprimet e tyre tregojnë se e dinë nga po shkojnë.

Gabor dhe Marika Nemethne, çifti Balassa, Marika Zabosne, ju falenderojmë që me suksesin tuaj kontribuat edhe në suksesin tonë.

Gurët e tjerë të çmuar të biznesit tonë janë managerët **Kriszta Varga dhe Laszlo Bodnar**, shembulli i angazhimit dhe dinamizmit të pabesueshëm. Janë gjithmonë me humor të mirë, e drejtojnë skuadrën e tyre nga dita në ditë me njohuri gjithmonë e më të mëdha. I falenderojmë që e besuan që ekziston edhe mënyrë tjetër jetese.

Aniko dhe Imre Toth të cilët janë shembulli i vërtetë i mënyrës se si mposhten rrethanat, pasi pranë një biznesi tepër të vështirë dhe një pune me turne i ndihmojnë me gjithë zemër dhe mjeshtri bashkëpunonjësit e tyre në rrugën drejt suksesit. Brenda një kohe të shkurtër edhe ata do të bëhen gurë të çmuar të biznesit tonë.

Ildiko dhe Imre Felegyhazi, tek të cilët është shumë i fortë shpirti i dëshirës për të mësuar dhe bashkëpunuar. Drejtues të vërtetë të aftë për t'i ndarë me të tjerët njohuritë, kohën, forcën dhe njerëzimin e tyre.

Judit Zolnai, e cila s'ka shumë kohë që u kualifikua në nivelin 25 pikësh, në jetën civile është tregëtare, edhe FLP-n e trajton si një biznes serioz dhe e ka të qartë se edhe në fusha të tjera duhet të bëjë përpjekje të mëdha duke kapërcyer pengesa të shumta për të arritur suksesin.

Dëshiroj të falenderoj fëmijët tanë që sillen me mirëkuptim që kohën, durimin dhe dashurinë tonë nuk ua kushtojmë vetëm atyre, por e ndajmë edhe me anëtarët e

familjes Forever. Shpeshherë me marrjen përsipër të problemeve dhe ngarkesave të përditshme na ofrojnë ndihmë të madhe në punën tonë.

Kjo skuadër ka një dinamizëm dhe forcë fantastike, çdo muaj kualifikohen anëtarë të rinj. Është diçka argëtuese që me miq dhe bashkëpunonjës të tillë pas meje të dëgjosh nga dita në ditë se ky biznes nuk funksionon. Por shumë njerëz thonë se ky biznes funksionon. S'kam kohë, s'kam të njohur, s'kam para, lojë piramidale, nuk di të shes. Dikush njëherë tha se në botë nuk ka të dështuar, por vetëm femra dhe meshkuj që nuk e dinë se janë të aftë të kenë sukses. Në skuadrën tonë ndodhen femra dhe meshkuj të cilët e dinë se janë të aftë të kenë sukses dhe e mposhtin vetveten, frikën dhe rrethanat e tyre. Prandaj dimë të jemi fitues në Klubin e Sundimtarëve, sepse ata janë bashkëpunonjës tanë.

Ata zotërojnë karakteristikë fituesi. S'është e sigurt se kështu kanë lindur, por e zhvilluan vetveten, e paguan çmimin e saj. Të dështuarit dorëzohen menjëherë nëse nuk u ecën diçka.

Puno njëkohësisht në tre fronte, më ka mësuar linja ime e sipërme, mentorët e mi **Dr. Zsolt Gönczi dhe Ilo-na Orosz**, nga të cilët në periudhat e vështira morra shumë ndihmë dhe mbështetje shpirtërore. Këtë mësova nga edhe nga safir managerët **Istvan dhe Rita Halmi**, të cilët ndodhen në lartësi të paimagjinueshme biznesi, por prapë nga dita në ditë kryejnë të njëjtën punë si secili prej nesh që e merr seriozisht këtë biznes, pasi bashkëpunonjësit e tyre kualifikohen vazhdimisht. Na ofrojnë ndihmë të madhe në punën tonë të përditshme. Kurset përgatitore të Hortobagyit dhe Miskolcitet të organizuara nga ata i japin skuadrës sonë vull të madh nga muaji në muaj. Istvan-i me leksionet

e tij e gdhend veten në librin e historisë së Forever-it.

Zgjerohet! – Mos hiq dorë nga sponsorizimi, këtë na mësojmë dhe këtë shikoj edhe në linjën time të sipërme. Pasi nëse nuk do mësonim të tjerët, nuk do të kishim linja të reja vëllazërore të cilët me këtë rast dëshiroj t'i falenderoj për ndihmën, mbështetjen e madhe dhe fjalët e mira që na japin vazhdimisht.

Mbaj prezantime! Prezantimet e përditshme janë shumë të rëndësishme. Nga dita në ditë të mbajmë prezantime në frontin tonë dhe në thellësi. Shumë njerëz thonë: Unë mbaj prezantime, por nuk vjen asnjëri? Ndërto marrdhënie! Siç thotë edhe **Istvan Halmi**: nuk ndërtojmë rrjet, por marrdhënie. Përmirësoi marrdhëniet e tua njerëzore!

Bëj gjithmonë ftesa për në prezantime të hapura dhe aktivitete! Ndoshta nuk vjen asnjëri, por prapë bëj ftesa! Jam i bindur se në dhomën e pritjes përpiqesh kot t'i mbushësh mendjen kandidatit tënd, nuk ia shpreh dot se ky është një biznes i madh. – As mua nuk ma shprehu dot nëna ime, dhe as unë burrit tim. Duhet ta shikojë me sytë e vet që kjo bëhet nga njerëz inteligjent dhe nuk është një veprimtari ilegale. Prandaj duhet ta ftosh dhe duhet ta sjellësh në prezantime të hapura dhe aktivitete. Nëse nuk e fton, e dënon me vdekje biznesin tënd.

Merre seriozisht kujdesin për blerësit! Kujdesi i vazhdueshëm për blerësit, kontakti i vazhdueshëm të ndihmon shumë të hysh në Klubin e Sundimtarëve. Kjo është baza e punës sonë, kjo do të japë edhe aktivitetin personal.

Bëhu drejtues i vërtetë, tha linja ime e sipërme, dhe Ata janë të tillë – pasi një drejtues i vërtetë mban të paktën 15 prezantime në muaj, ka të paktën 18-20 blerës të përhershëm dhe 4 pikë aktive, është 100% konsumator produktesh, merr pjesë në aktivitete, dëgjon vazhdimisht CD-t dhe kasetat, lexon të paktën 1 libër biznesi të rekomanduar në muaj, punon në skuadër, mëson nga gabimet, disfatat dhe nuk dorëzohet kurrë, me veprimet e tij jep shembull dhe kështu drejton biznesin e tij.

Nuk është e detyruar të bëhesh drejtues, secili e vendos vetë se çfarë bën në interes të rritjes së shpejtë të biznesit të tij.

Në FLP secili është vullnetar dhe bën atë që dëshiron. Secili mund të vendos të bëhet drejtues, por nga njëqind njerëz vetëm disa do bëhen të tillë. Cili është ai që dëshiron një njeri të tillë në biznesin e tij? Cili dëshiron të dijë se si mund të sigurohet një njeri i tillë?

Ekziston vetëm një mënyrë e sigurt e cila garanton që në biznesin tënd të bëhet të paktën një njeri i tillë, dhe ky njeri je ti. Në atë moment jeta jote ndryshon plotësisht. Rezultatet vijnë në varësi të punës tënde. Dhe kjo ta shton besimin në vetvete në nivelin që bëhesh i pakundërshtueshëm për njeriun e duhur. Si një magnet do t'i tërheqësh në biznesin tënd njerëzit që kanë parime dhe tipare të njëjta me ty. Njerëzit nuk e ndjekin atë që përpiqet. Por do ta ndjekin atë që e di mirë se çfarë dëshiron. Dhe ata që ndjekin shembullin tënd do të bëhen gjithashtu të suksesshëm.

Këtë proces e quajmë përvetësim. Ka shumë rëndësi se çfarë parimesh dhe metodash përvetësohen në biznesin tënd. Prandaj është diçka e zgjuar të japësh shembullin e duhur. Përdor një metodë e cila funksionon jo vetëm për ty, por edhe për bashkëpunonjësit e tu. Qëndrimi drejtues është ai që i ndan ata që kanë sukses në FLP nga ata që vendosin ta bëjnë, por përveç kësaj nuk bëjnë asgjë tjetër.

FLP-ja u jep njerëzve ndjenja, qëllime në jetë, miq dhe marrdhënie njerëzore. Edhe ne për këtë hymë në Forever. Ndoshta tani shikon sukseset e të tjerëve dhe mendon: sigurisht, sepse ai e filloi atëherë. Duhet të them se nuk varet nga kjo. Varet nga fakti që a mund të ngrihesh kur rrëzohesh përdhe. Në këtë biznes s'ka dënim, ka vetëm vlerësim, dhe vlerësimi vjen kur mposht vetveten dhe thua, do ta zgjidh.

Nëse dëshiron një biznes të madh, sillu mirë me vetveten, respektoje dhe vlerësoje vetveten që edhe Ti i meriton gjërat e mira. Meriton të kesh një jetë të rehatshme, meriton të shikosh fëmijët kur rriten, dhe jo të takohesh me ta vetëm kur i puth në mëngjes dhe në darkë. Edhe ti meriton ta çosh familjen tënde në bregdet. Edhe ti meriton një jetë më të shëndetshme, më të sigurt dhe të pavarur. Dhe mos thuaj se përse pikërisht unë, unë s'kam për të patur sukses. Duhet ta duash vetveten që edhe ti ta meritosh, dhe nëse nuk e beson këtë, atëherë ulu me sponsorin tënd apo me dikë nga linja jote e sipërme, me të cilin mund të lidhësh marrveshje, tek i cili ke besim, të cilin e adhuron dhe mendon se ai është shembull

edhe për ty. Prano këshillën e tij dhe bëj çfarë të thotë! Nëse sot vendos në vetvete që do të kualifikohesh në një nivel të ri, ke besim në vetvete dhe konsultohesh me drejtuesin tënd, më beso që në fund të muajit do të kesh rezultat. Nuk varet nga asnjëri tjetër, vetëm nga ty!

Vetëm në një mënyrë mund ta arrish qëllimin tënd, po ta fillosh prej aty ku je tani. Shumë njerëz, kur mendojnë për suksesin, arrijnë në konkluzionin se prej këtu ku jam tani, rruga nuk më çon atje. Përpiqen të kenë sukses duke u dhënë pamje tjetër gjërave, dhe janë të bindur se prej aty ku ndodhen, rruga nuk të çon drejt suksesit.

Por nëse dëshiron të bëhesh i suksesshëm, duhet ta fillosh prej aty ku je tani. Edhe sundimi i majës së malit fillon me hapin e parë, por duhet ta dish se për këtë hap të parë duhet të mposhtësh vetveten, dhe jo majën e malin.

Ke ëndrra? Cila është ëndrra jote? Të besohet se e meriton? Je i gatshëm të paguash çmimin e saj? Kur fillon të luftosh për të? Zakoni më i keq është shtytja për më vonë e gjërave. E dime se çfarë duhet të bëjmë, por nuk e bëjmë tani, sepse mund ta bëjmë edhe nesër, por e nesërma nuk vjen kurrë. Ilaçi i vetëm kundër shtytjes për më vonë është veprimi i vendosur. Bëj atë që mund ta bësh tani dhe mos prit për momentin e përshtatshëm, sepse momenti i përshtatshëm është tani! Bëj atë që mund të bësh me çfarë ke, aty ku je, dhe atëherë edhe Ti mund të bëhesh fitues i Klubit të Sundimtarëve.

Të urojmë për këtë këmbëngulje dhe suksese të shumta!

Botuese: Kompania Forever Living Products, Hungari. • **Redaktoi:** FLP Magyarországn Kft. 1067 Budapest, Szondi u. 34. Telefon: (36-1) 269-5373 Fax: (36-1) 312-8455 • **Redaktori kryesor:** Dr. Milesz Sándor • **Redaktor:** Kismárton Valéria, Petrőczy Zsuzsanna, Pósa Kálmán, Rókás Sándor • **Përgatitja për shtypje:** Tipofill 2002 kft. **Grafika:** Teszár Richárd, Buzássy Gábor • **Shtypi:** Veszprémi Nyomda Zrt. U përgatit në 49 250 kopje • **Përkthyes, redaktues:** shqip: Dr. Marsel Nallbani – kroat: Darinka Aničić, Anić Antić Žarko – serb: Tóth-Kása Ottilia, Molnár Balázs, Meseldžija Dragana – sloven: Novak Császár Jolanda, Biro 2000 Ljubljana Për përbajtjen e artikujve shkruetit mbajnë përgjegjësi! Çdo e drejtë mbrohet!



MISS FOREVER SERBIA

